



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

GJYKATA THEMELORE
OSNOVNI SUD
PRISHTINE-PRISTINA
PRANUAR PRILJENÇ

20 10 2017 13 32

Nr. 1316/2017

Për: Znj. Afërdita Bytyqi, Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë
Nga: Osman Havolli, kryetar i OAK
Datë: 20/10/2017
Lënda: Kërkesë për eliminimin e praktikës të fillimit të punës me avokatë në Gjykatën Themelore të Prishtinës pas ores 09:00

E nderuar znj. Bytyqi


Oda e Avokatëve të Kosovës, në përpjekje për të avancuar sundimin e ligjit dhe eliminimin e pengesave gjatë ushtrimit të profesionit të avokatisë në mbledhjen e Këshillit Drejtues ka trajtuar fenomenin e fillimit të punës me avokatë dhe lejin e hyrjes se tyre në Gjykatën Themelore në Prishtinë vetëm pas orës 09:00.

Kemi hasur ankesa të avokatëve lidhur me seancat gjyqësore të caktuara në ora 09:00, e që avokatëve nuk ju lejohet hyrja para kësaj ore dhe kjo ka ndikuar që avokatët pa fajin e tyre të vonohen me çka ka krijuar problematika procedurale në seanca gjyqësore.

Nën rrethanat e ngarkesave të gjykatave me lëndë dhe kohëzgjatjes së trajtimit të lëndës, krijon humbje në aspektin kohorë për Gjykatën, Avokatët dhe palët tjera në procedurë.

Duke marrë parasysh se procesimi respektivisht pranimi i shkresave në Gjykatë bëhet në menyrë elektronike, konsiderojme së kjo nuk paraqet asnjë pengesë për stafin administravë të gjykatës të kryejn punën e tyre si në të gjitha Institucionet publike në orarin e përcaktuar dhe atë prej orës 08:00-16:00, ashtu që në këtë mënyrë do të reflektonte edhe një frymë më e mirë e bashkëpunimit në mes avokatisë dhe gjykatave.

Për Këshilli Drejtues të OAK


Osman Havolli, Kryetar
Oda e Avokateve te Kosoves

Adresa: Prishtinë, Rr. Bedri Pejani nr 31, Tel 038 244586 e-mail: info@oak-ks.org